



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1264/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Asan Avdullahi, sekretar organizativ i subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës të vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pa afatshme ankesa e Asan Avdullahi sekretar i subjektit politik Partia e Ashkanlinjëve për Integrim (PAI) në Lipjan.

Arsyetim

Me datë 03.12.2013 në ora 17:50, Asan Avdullahi sekretar organizativ i PAI-të në Lipjan ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në VV nr:1302E është bërë bartja e votave të subjektit të tretë i quajtur GIS, dhe me këtë rast ndjehemi të dëmtuar, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjetise:

ankesa është e pa afatshme

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndë se ankesa e Asan Avdullahi është e pa afatshme sepse afati ligjor sipas LZP-së është 24 orë nga momenti kur KQZ-ja e ka shpallur vendimin që nënkupton se ky afat ka qenë deri me dt. 03.12.2013 në ora 16:30, ndërsa pala ankuese ankesën e ka parashtruar në PZAP, në ora 17:50, nga kjo del se ankesa në fjalë është parashtruar 1 orë e 50 minuta pas afatit të paraparë ligjor. Andaj duke u bazuar në Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it nenin 4.2 dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa afatshme, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1264/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.